



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 48/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit AAB, dega në Ferizaj, Nr 3502/21H, datë 29.10.2021 për akreditim të programit të studimit, si më poshtë:

- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS (Akreditim).

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë (Nr 3502/21H, datë 29.10.2021), në Agjencinë e Kosovës për ri/akreditim për akreditim të programeve të studimit.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit AAB. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”.

Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur më 21 dhjetor 2021, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzoj pjesërisht aprovimin e aplikacionit të Kolegjit AAB. Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit.

Për programin e studimit: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Pranvera Dalloshi, Fëllënze Pula, Donat Rexha.

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se nga bartësit e programit vetëm Donat Rexha plotëson kriterin e publikimeve shkencore

sipas vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr. 3236/21D të datës 21.09.2021 për plotësim e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, pika 5.1 e tij, ku përcaktohet se: *Nga 1 tetori 2021, përveç kriterëve të përcaktuara me UA për akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivel BA/BSc duhet të kenë të paktën 1(një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë së paku 2 (dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCE koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI), apo 1.2 SCOPUS, duke përfshirë revistat ose shtëpitë botuese të dyshimita sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHT.*

Të dy bartësit e tjerë që janë Pranvera Dalloshi dhe Fëllënze Pula nuk plotësojnë kriteret e sipër përmendura.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që për shkak të mos përmbushjes së Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe vendimit të KShC-së Nr. 3236/21D datës 21.09.2021, të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB, dega në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Elasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

